

## PLANI DITOR

Emri dhe mbiemri i mësimitdhënësit : Naser Kastrati

Data:

Lënda: Gjuhë shqipe

Kohëzgjatja e orës : 40 min

Klasa: II / 1

Njësia mësimore: Të flasim : Jemi të pastër

Tipi i orës (Nënvizo) : a) Zhvillim b) Përsëritje c) Ushtrim ç) Vlerësim d) Testim

Rezultatet e të nxënësve : Në fund të orës mësimore, nxënësve do të jenë në gjendje të :

1. Komunikojnë me njëri me tjetrin rreth pastërtisë.
2. Diskutojnë për pastërtinë.
3. Zgjerojnë dhe gjallërojnë fjalorin që lidhet me këtë temë.

Qëllimi i të nxënësve : Të mësojnë për pastërtinë

Kriteret e suksesit :

- \* Përkrahuesit dhe vlerësojnë veprimet që bëjnë fëmijët në figurat që shikoni.
- \* Vlerësojnë veprimet jo të rregullta të kryera nga fëmijët.
- \* Luani rolet e fëmijëve .
- \* Tregoni arsyejen e shqetësimit të Blendit.
- \* Tregoni shembuj pastërtie shembullore në klasën tuaj.

Fjalët kyçe : pastërti, papastërti, .

Vlerësimi : Parashtrim i pyetjeve, ngjyrat e semaforit

Materialet dhe burimet e nevojshme për mësimitdhënie / aktivitetet: Libri i gj.shqipe shkumsi, tabela etj

Përshtatja me nevojat e nxënësve : Aktivitetet që mundësojnë përfshirjen e të gjithë nxënësve.

Procedurat e mësimitdhënies dhe plani i vlerësimit

STRUKTURA E ORËS		TEKNIKAT E MËSIMDHËNIES	Koha
EVOKIM	E	Stuhi mendimesh	5'
REALIZIMI I KUPTIMIT	R	( DRTA ) Lexim i drejtuar	25'
REFLEKTIMI	R	Pyetje për diskutim	10'

## ZHVILLIMI I MËSIMIT

Vlerësimi  
në fillim  
të mësimit

### EVOKIM- E:

Këtë fazë të orës mësimore do të fillojmë me një aktivitet që nxënësit të kuptojnë lidhshmërinë e njësive mësimore që do të zhvillojmë. Duke u parshtruar disa pyetje . **Parashtimi i pyetjes**

-Çfarë dini për pastërtinë ?  
-Cilat janë mjete që përdorim për pastërtinë? Nxënësit do të sjellin përgjigje të ndryshme rreth pyetjeve.

Vlerësimi  
gjatë  
mësimit

### REALIZIMI I KUPTIMIT – R: - ( DRTA ) Lexim i drejtuar

Mandej nxënësit do t'i udhëzoj t'i hapin librat e gj. shqipe f. 95

- Do të lexojnë ushtrimet me radhë dhe pas çdo ushtrimi do të ketë pyetje për diskutim

#### - Lexohet ushtrimi i parë. Pyetje për diskutim

-Çfarë bëjnë Mira dhe Drita? **Parashtrimi i pyetjeve**

Ndër përgjigjet më të mundshme të nxënësve mund të veçojmë:

Mira dhe Drita janë të rregullt edhe të pastëra.

Ato i pastrojnë dhëmbët rregullisht .

Lahen me kujdes, krihen dhe vishen vetë.

Nëna është e kënaqur me to.

Unë mendoj se Drita dhe Mira veprojnë mirë.

Ne fëmijë duhet gjithmonë t'i pastrojmë dhëmbët dhe jemi të pastër gjithnjë.

**Lexohet ushtrimi i dytë.** Dhe pas leximit fillojmë dialogun me nxënës.

-Vëllai i Zanës zemërohet dhe i drejtohet motrës me këto fjalë:

-Zanë nuk veproje mirë. Nuk hidhen lëkurët përdhe.

- Ç'bën ,moj Zanë ?! Po në shtëpi kështu vepro?

Kjo është sjellje jo e mirë.Nuk veprohet kështu.

**Lexohet ushtrimi i tretë.** Dhe pas leximit fillojmë diskutimin me nxënës:

-Çfarë i thotë ajo Dritanit? Po ai si i përgjigjet ?

Ç'je bërë kështu , Dritan ? Me se ke luajtur ? S'të vjen turp?

Nuk shihesh dot në fytyrë. Shko shihu në pasqyrë. Shko lahu , pastaj eja dhe fol me mua!

Kemi luajtur futboll dhe jam bërë me djerës , prandaj më është bërë fytyra pis.Do të lahem tani.

**Lexohet ushtrimi i katërt.** Dhe pas leximit fillojmë diskutimin me nxënës:

Pse është i shqetësuar Blendi? Pse mendoni ashtu ?

Sa janë të kuptuara për ju ushtrimet?(Nx. me ngritjen e ngjyrave të semaforit tregojnë sa e kanë kuptuar)

### REFLEKTIM – R: - Pyetje për diskutim

Në fund nxënësve u kërkoj të përgjigjen në disa pyetje :

- Ç' mendim keni ju për Miren dhe Dritën?

- Pse e qortoi i vëllau Zanën?

- Çka i tha motra Dritanit?

**Detyrë shtëpie:** Nxënësit të shkruajnë në fletore për ushtrimin 5.

**Vetëvlerësimi-** Analizë e orës së mbajtur: a) Plotësisht i kënaqur b) I kënaqur c) Nuk jam i kënaqur.

Nëse nuk jeni të kënaqur, tregoni dy – tri arsye.

1. \_\_\_\_\_ 2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

Vlerësimi  
pas  
mësimit